

**SHPLLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:  
SPECIALIST, DREJTORIA E KOORDINIMIT**

**1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS**

**Emërtesa e pozicionit:** Specialist i Drejtorisë së  
Koordinimit

**Raporton te:** DREJTORI I DREJTORISË SË  
KOORDINIMIT

**Periudha e punësimit:** E përkohshme/zëvendësim i  
punonjësit me leje lindje

**II. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT:** Specialisti i Drejtorisë së Koordinimit (I) përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit për mbajtjen e korrespondencave dhe komunikimit me partnerë të huaj dhe vendas, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe për komunikimin dhe bashkërendimin e punës me drejtoritë e tjera të Agjencisë.

**III. DETYRAT KRYESORE:**

- Mban korrespondencat, komunikimet dhe bashkërendimet me organizata dhe partnerë të huaj, me qëllim kryerjen me sukses të aktiviteteve ku Agjencia është partner;
- Mban kontaktet më ministrinë dhe institucione të tjera brenda vendit, koordinon dhe bashkërendon punët, që në momentin e planifikimit deri në momentin e zbatimit dhe raportimit;
- Komunikon dhe bashkërendon me Ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe financat dhe atë përgjegjëse për punët e jashtme, në kuadër të trajtimit të investitorëve, grupeve të sipërmarrësve etj;
- Bashkërendon dhe koordinon me drejtoritë e tjera, lidhur me kryerjen në kohë të angazhimeve që rrjedhin nga partneritetet me aktorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë.

**IV KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI**

**Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

**Arsimi:** Master profesional në shkenca juridike/ekonomike/inxhinierie. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

**Përvoja:** Të ketë paktën 1 (një) vit eksperiencë pune.

**Tjetër:** Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre. Të ketë njohuri të gjuhës angleze; njohja edhe e gjuhëve të tjera përbën avantazh.

## **V. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;

b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim ,dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës:**19.04.2022.**

## VI. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në datën : **20.04.2022**, AIDA do të realizojë

- I. **Fazën e parë** të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore:
  - a- Nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim
  - b- Nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës.
- II. **Faza e dytë** të konkurrimit e cila është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

## VII. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen . Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.